

URDHËR
Nr. 360, datë 5.9.2013

PËR MËNYRËN E NJOFTIMIT ELEKTRONIK TË AKTEVE GJYQËSORE

(ndryshuar me urdhrin Nr. 387, datë 12.6.2023)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, si dhe nenit 141 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Njoftimi elektronik, si një ndër mënyrat e njoftimit të akteve gjyqësore bëhet nga *punonjësi i gjykatës* nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik dhe ndiqet nga gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes, i cili kontrollon dhe kujdeset për procesin e zhvillimit të tij në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Thirrja në gjykatë, nëpërmjet lëtrëthirrjes, urdhërohet të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, në rast se çmohet e dobishme nga gjykata dhe kur pala ose *personi i tretë* ka dhënë pëlqimin paraprak, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

3. *Njoftimi elektronik bëhet me mjete të komunikimit elektronik që mundësojnë marrjen e njoftimit në adresën e postës elektronike apo numrin e kontaktit të deklaruar nga vetë pala apo personi i tretë. Punonjësi i gjykatës dokumenton dërgimin dhe marrësi duhet të konfirmojë marrjen e njoftimit brenda 5 ditësh. Me kalimin e këtij afati, njoftimi konsiderohet i kryer.*

4. *Njoftimi elektronik i paditësit, të paditurit apo përfaqësuesve të tyre bëhet kur, sipas rastit, në kërkesëpadi, deklaratën e mbrojtjes, si dhe në mjetet e ankimit janë paraqitur të dhënat elektronike të kontaktit, si dhe deklaratat e pranimi të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik.*

4/1 Gjykata i kërkon personit të tretë konfirmimin e adresës dhe paraqitjen e të dhënave elektronike të kontaktit të tij apo përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, ku gjykata kryen njoftimet. Njoftimi elektronik i personit të tretë kryhet kur ai e ka pranuar përmes deklaratës së pranimi të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik.

5. Në rast se vërtetohet nga punonjësi i gjykatës se pala, përfaqësuesi i saj, nëse ka një të tillë apo personi i tretë ka ndryshuar të dhënat elektronike të kontaktit dhe gjykata nuk është njoftuar për të dhënat e reja, në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 129 të Kodit të Procedurës Civile, pretendimet e tyre për pavlefshmërinë e njoftimit janë të papranueshme. Në këtë rast, njoftimi bëhet me shpallje publike, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

6. Për njoftimin e vendimit të gjykatës ndiqen të njëjtat rregulla, të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij urdhri.

7. Në çdo rast, njoftimi bëhet duke respektuar legjislacionin për komunikimet elektronike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Njoftimi pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, i cili hartohet dhe përmban elementet e parashikuara në nenin 141 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.

9. Për arkivimin dhe ruajtjen e procesverbalit të njoftimit ndiqen të njëjtat rregulla si për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur në formën e një përmbledhjeje me shtypshkrim apo dorëshkrim.

10. *Ngarkohen gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për*

zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

12. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi